

UDHËZUES PRAKTIK

# Bashkitë për të drejtën e informimit në veprim

Ky udhëzues u mundësua nga asistenca e projektit “Konsolidimi i Reformës Administrative dhe Territoriale – STAR2”, i cili zbatohet nga Qeveria Shqiptare në partneritet me Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Tiranë dhe mundësohet nëpërmjet mbështetjes dhe bashkëpunimit me Bashkimin Evropian, qeverive të Suedisë, Italisë, Zvicrës dhe USAID.

Ky udhëzues u përgatit nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në kuadër të angazhimit për të zhvilluar Modelin e Programit të Transparencës për njësitë e qeverisjes vendore.

#### INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM

Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1, 1017

PO Box 8177 Tirana, Albania

T +355 4 240 0241

[www.idmalbania.org](http://www.idmalbania.org)


*Layout & Design: Eduart Cani*

#### SQARIM

Ky botim elektronik është përgatitur me mbështetjen e donatorëve të Projektit STAR 2 (Bashkimi Evropian, Qeverive të Suedisë, Italisë, Zvicrës dhe USAID si dhe Zyrën e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Tiranë). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e autorëve dhe nuk pasqyron pikëpamjet e donatorëve.



Funded by  
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development  
and Cooperation SDC



USAID  
FROM THE AMERICAN PEOPLE



Empowerment lives.  
Resilient nations.

# Përmbajtja

Hyrje	5
Rreth Udhëzuesit	6
<b>PJESA I: PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI I NJË FUSHATE TË SUKSESSHME NDËRGJEGJËSIMI</b>	<b>15</b>
Hapi 1: Përcaktimi i objektivave	18
Hapi 2: Identifikimi i audiencave të synuara	20
Hapi 3: Krijimi i mesazhit të fushatës së ndërgjegjësimit	24
Hapi 4: Përzgjedhja e aktiviteteve dhe strategjive	25
Hapi 5: Përzgjedhja e kanaleve të komunikimit	27
Hapi 6: Zbatimi i planit të fushatës	29
Hapi 7: Monitorimi dhe vlerësimi i fushatës së ndërgjegjësimit	29
<b>PJESA II: PRAKTIKA TË MIRA NË NDËRGJEGJËSIMIN PUBLIK PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT</b>	<b>31</b>
Në nivel vendor	32
Në nivel rajonal dhe ndërkombëtarë	34
Vlerësime të Koordinatorëve për të Drejtën e Informimit	35



# Hyrje

E drejta për informim dhe pjesëmarrja e qytetarëve në proceset vendimmarrëse janë elementë thelbësorë për një qeverisje vendore të hapur dhe gjithëpërfshirëse. Për garantimin e këtyre të drejtave janë në zbatim dy ligje të rëndësishme, ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ligji nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” si edhe kuadri ligjor mbi qeverisjen e mirë në nivel vendor. Megjithatë, pavarësisht zhvillimeve në fushën e transparencës dhe llogaridhënies zbatimi efektiv i kuadrit përkatës ligjor kryesisht në nivelin vendor ende përbën një sfidë.

*“Bashkitë nuk kanë arritur të garantojnë informimin e qytetarëve në zonat e largëta dhe shtresave e grupeve në nevojë (të varfërve, të papunëve, të personave me aftësi të kufizuar, të vetëpunësuarve në ekonomitë dhe në fermat familjare si dhe grupeve pakicë). Bashkitë nuk kanë miratuar rregulla të brendshme për informimin e këtyre grupeve si dhe nuk kanë gjetur dhe vendosur kanale të përshtatshme informimi dhe komunikimi me to.”<sup>1</sup>*

Në këtë kontekst, ky Udhëzues synon t’i përgjigjet nevojës së dukshme të bashkive të vendit për njohuri dhe aftësi që do të mundësonin informimin dhe komunikimin me grupet e ndryshme komunitare dhe aktorë të tjerë të interesit. Për këtë arsye, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), në kuadër të projektit “Konsolidimi i Reformës Administrative dhe Territoriale – STAR 2, organizoi një Program Trajnimi tre ditor me 25 Koordinatorë të së drejtës së Informimit të bashkive të ndryshme të vendit. Trajnimi i të mësuarit jo-formal “Bashkitë për të drejtën për informim në veprim” u zhvillua më 12-14 Shtator 2018 me synimin për të përmirësuar aftësitë e Koordinatorëve në drejtim të rritjes së ndërgjegjësimit të qytetarëve dhe promovimit të transparencës dhe llogaridhënies në shërbim të publikut dhe grupeve të interesit.

1 Raport Vlerësimi: Situata aktuale, sfidat dhe mundësitë për transparencë dhe llogaridhënie efektive në nivelin e vetëqeverisjes vendore në Shqipëri (IDM, 2018)

Konkretisht, ky udhëzues bëhet i mundur në një kohë kur bashkive të vendit u ofrohet një Model standart i Programit të Transparencës për njësitë e qeverisjes vendore – i hartuar në përputhje me ligjin nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe i përshtatur në kontekstin e vetëqeverisjes vendore, me misionin, detyrat, funksionet dhe kompetencat e bashkisë. Zbatimi i modelit të Programit të transparencës do të asistojë bashkitë të jenë proaktive në ofrimin në kohë të informacionit publik për qytetarët duke ndikuar kështu në përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies në nivelin e qeverisjes vendore.

## Rreth Udhëzuesit

Përmbajtja e Udhëzuesit mbështetet në përvojën dhe ndërveprimin e pjesëmarrësve në programin e trajnimit “Bashkitë për të drejtën e informimit në veprim”, kombinuar edhe me informacionin e ekspertit të komunikimit që lehtësoi këtë aktivitet. Udhëzuesi dokumenton njohuritë dhe praktikatat ekzistuese në informimin publik që pjesëmarrësit kanë ndarë gjatë ditëve të trajnimit dhe njëkohësisht ofron një paraqitje sistematike të informacionit dhe ushtrimeve konkrete sipas hapave kryesorë në të cilën kalon planifikimi dhe zbatimi i një fushatë ndërgjegjësimi për të drejtën e informimit në nivel vendor.

Udhëzuesi përpiket t’u japë përgjigje pyetjeve të mëposhtme kryesore:

- Si të planifikoj një fushatë ndërgjegjësimi publik për të drejtën e informimit për grupe të ndryshme komunitare në bashkinë time?
- Si ta transformoj planin në një fushatë ndërgjegjësimi? Cfarë mesazhi të komunikoj? Kujt? Në ç’mënyrë? Sa shpesh? Më kë më duhet të bashkëpunoj?
- Si të di që kam arritur qëllimet e fushatës së ndërgjegjësimit?

Përmbajtja në cdo rubrikë kombinon një prezantim të shkurtër teorik të hapave kryesore dhe koncepteve përkatëse me aplikime konkrete të tyre nëpërmjet punëve në grupe. Në këtë mënyrë, Udhëzuesi ofron një set instrumentesh specifikë që bashkitë mund të përdorin, rishikojnë, përshatësin me qëllimin e fushatës së tyre të informimit.

Pjesa e fundit e Udhëzuesit ofron një dokumentim të praktikave ndërkombëtare dhe kombëtare në lidhje me ndërgjegjësimin publik për të drejtën e informimit. Kjo rubrikë do të lehtësonte aksesin e Koordinatorëve dhe përfaqësuesve të bashkive në instrumentet ndërgjegjësimi për të drejtën e informimit. Kjo pjesë është e strukturuar në një mënyrë që ofron informacion në secilën prej praktikave: Cfarë? Pse? Kush? Ku? Kur?.

## **Cili është qëllimi i Udhëzuesit?**

Ky Udhëzues ka si qëllim të paraqesë në mënyrë të thjeshtuar dhe praktike hapat dhe instrumentet për planifikimin dhe zbatimin e suksesshëm të një fushate ndërgjegjësimit për të drejtën e informimit në nivel vendor. Me anë të këtij udhëzuesi përfaqësuesit e institucioneve të qeverisjes vendore mund të: identifikojnë dhe përdorin instrumentet e duhura për të targetuar qytetarët apo grupe të ndryshme interesi. Gjithashtu, udhëzuesi ndihmon në përzgjedhjen e strategjive më të mira për të nxitur interesin dhe përfshirjen më të gjerë në të gjithë spektrin e proceseve vendim-marrëse në nivelin vendor.

Qëllimi specifik është pajisja e përfaqësuesve të njësive të qeverisjes vendore me një paketë të pasur me praktika konkrete të fushatavë të ndërgjegjësimit për informimin publik, instrumenteve specifik të ndërgjegjësimit, sugjerimeve konkrete për një fushatë të suksesshme ndërgjegjësimit në të cilat ata mund të mbështeten për të zhvilluar instrumentet e fushatës së tyre duke i përshtatur me kontekstin e tyre specifik.

## **Kujt i dedikohet ky Udhëzues?**

Kjo Guidë është përgatitur kryesisht për përfaqësuesit e njësive të qeverisjes vendore duke përfshirë të tre nivelet: ekzekutiv, vendimmarrës dhe administrata. Udhëzuesi është përgatitur në frymën e ligjit për të drejtën e informimit si dhe të ligjit organik.

*“E drejta e informimit  
– si e drejtë themelore  
e njeriut dhe parim i  
qeverisjes së mirë”*



*Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe njoftimit të informacionit dhe ideve me çfarëdo mjeti qoftë, pa marrë parasysh kufijtë.*

**DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT, Neni 19**

Liritë dhe të Drejtat Vetjake

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

**KUSHTETUTA  
e Republikës së  
Shqipërisë, Kreu II  
Liritë dhe Të Drejtat  
Vetjake, Neni 23**

**LIGJI Nr. 119/2014  
“Për të drejtën e  
informimit”, Kreu II  
E drejta e informimit  
dhe transparencja;  
Neni 3**

E drejta e informimit

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Transparenca e veprimtarisë së njësisë të vetëqeverisjes vendore

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore garantojnë për publikun transparencën e veprimtarisë së tyre.
2. Çdo akt i organeve të vetëqeverisjes vendore publikohet në faqen zyrtare të internetit të njësisë vendore dhe afishohet në vendet e caktuara nga njësia për njoftimet publike.
3. Çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar të caktojë koordinatorin e transparencës dhe të miratojë programin e transparencës, duke siguruar akses nga të gjithë, veçanërisht nga shtresat më të varfra të komunitetit, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit.

**LIGJI Nr. 139/2015  
‘Për Vetëqeverisjen  
Vendore’  
Kreu VI: Transparenca,  
Konsultimi dhe  
Pjesëmarrja Qytetare**

## *“Qeverisja e mirë” është e qytetarëve, nga qytetarët, për qytetarët”*

Në thelb të qeverisjes së mirë vendore qëndrojnë dy parime të rëndësishme - transparencja dhe llogaridhënia.

Në kuptimin teorik, transparencja konsiston në publikimin e informacionit procedural dhe përmbajtësor të shërbimeve publike, në mënyrë të tillë që të jetë i aksesueshëm dhe gjerësisht i kuptueshëm nga individët dhe grupe të caktuara të shoqërisë, duke respektuar kufizimet e arsyeshme për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë.

## *Pa parimin e transparencës, një qeverisje e mirë ka shumë pak kuptim.*


Ndërsa llogaridhënia ka të bëjë me përgjegjshmërinë e zyrtarëve publikë dhe atyre që ndikojnë këta të fundit në vendimmarrje, për veprimet e kryera në përputhje me procedurat ligjore. Ndryshe, parimi i llogaridhënies në këndvështrimin institucional njihet si “kontrollo dhe balanco” (check and balance).

Kur flasim për njësitë e vetë-qeverisjes vendore nevoja për informim publik dhe sigurimin e transparencës dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimarrjen vendore është domosdoshmëri. Kjo për shkak se bashkitë përfaqësojnë nivelin e qeverisjes më pranë qytetarëve dhe janë ofruesit e shërbimeve publike në nivel vendor.

# *Informimi - hapi i parë drejt pjesëmarrjes qytetare në qeverisjen lokale dhe njëkohësisht forcimit të legjitimitetit të njësive të vetë-qeverisjes vendore.*

## **Shkallët e pjesëmarrjes qytetare**

Pjesëmarrja dhe angazhimi qytetar në qeverisjen lokale përfshin lloje të ndryshme të angazhimit që karakterizohen nga nivele të ndryshme të intensitetit të pjesëmarrjes. Për këtë arsye, këto nivele angazhimi të pjesëmarrjes qytetare emërtohen shkallët e pjesëmarrjes qytetare, të cilat përmenden më poshtë:




**Informimi** përfshin nivelin më të ulët të pjesëmarrjes qytetare ose “mungesë pjesëmarrje”. Në këtë nivel komunikimi është me një kah dhe përfaqëson marrëdhënien në të cilën qeverisja udhëzon, edukon, ose thjesht tregon, komunikon diçka.

**Konsultimi** – përfaqëson nivel më të rritur të pjesëmarrjes. Tregon një marrëdhënie me dy kahe ku aktorët e interesit kanë mundësi të shprehin sugjerime dhe nevojat e tyre në lidhje me çështjen e konsultimit. Megjithatë, konsultimi nuk siguron që inputi i qytetarëve dhe grupeve të interesit do të përdoret. Në fakt, konsultimi realizon atë që quhet pjesëmarrje e ftuar e qytetarëve, ku hapësira fizike dhe agjenda e konsultimit përcaktohen dhe dominohen nga qeverisja.


**Partneritet:** qytetarët janë pjesë e vendim-marrjes. Kjo nënkupton ndërveprim të rritur të qytetarëve të cilët negociojnë me qeverisjen. Ky nivel pjesëmarrje rrezikon që grupet e cënueshmë të shoqërisë të mos artikulojnë pikëpamjet e veta.

**Vendimarrje e përbashkët:** përfaqëson nivelin më të lartë të angazhimit qytetar në vendimarrje. Ky nivel shënon edhe fillimin e ndarjes së përgjegjësive për rezultatet e vendimarrjes.



Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet thelbësore të qeverisjes së mirë dhe janë të lidhura ngushtësisht me njëra-tjetrën. Hapja dhe transparenca e autoriteteve të qeverisjes vendore përfaqëson një hap të parë drejt llogaridhënies së të zgjedhurve vendorë.

Të dy parimet, janë parakushte dhe kushtëzojnë ndërveprimin me qytetarët dhe ndërtimin e besimit me komunitetin. Kur një bashki është e hapur dhe transparente, qytetarët janë më aktiv dhe bëhen lehtësisht pjesë e proceseve vendore duke ndikuar vendimmarrjen vendore nga e cila ndikohet jeta e tyre. Si rrjedhim të pjesëmarrjes më të rritur të qytetarëve, zyrtarët janë më të përgjegjshëm, me etikë dhe integritet. Ata mbajnë llogari për vendimet e tyre para komunitetit dhe grupeve të ndryshme në komunitetet. Si rrjedhim, besimi i qytetarëve rritet në qeverisjen vendore duke ndikuar pozitivisht edhe në legjitimitetin e qeverisjes vendore.



Në aspektin ligjor për transparencën në nivelin e vet-qeverisjes vendore, Shqipëria ka një kornizë ligjore të mirë e cila ka si qëllim garantimin e institucioneve transparente në funksion të qytetarëve. Kushtetuta, Karta e

Evropiane për Vetëqeverisjen Vendore, ligji për vetëqeverisjen vendore, ligji për financat e vetëqeverisjes vendore, ligji për të drejtën e informimit, ligji për njoftimin dhe konsultimin publik janë dokumentet themelore që rregullojnë transparencën e institucioneve vendore.

Detyrimet ligjore që rrjedhin nga Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, dhe Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” u garantojnë qytetarëve akses në qeverisje dhe kushtet e duhura për të ushtruar të drejtat e tyre qytetare. Ligji për të drejtën e Informimit përfshin informimin me kërkesë dhe pa kërkesë:

Informimi me kërkesë: e drejta qytetarëve të kërkojnë informacion pa shpjeguar motivet e kërkesës dhe detyrimi i institucioneve publike për të përbushur këtë të drejtë duke respektuar kufizimet e të drejtës së informimit.

<p>Informimi pa kërkesë: detyrimi i institucioneve publike për të publikuar një gamë të madhe informacionesh publike që prodhohen dhe disponohen nga ato. Informimi pa kërkesë realizohet nëpërmjet Programit të transparencës i cili përkufizohet si tërësia e informacionit dhe mënyrat e bërjes publike të tij nga autoriteti publik.</p>	<p><i>Programi i Transparencës përfaqëson instrumentin kryesor të transparencës në nivel vendor, që çdo njësi e vetëqeverisjes vendore është e detyruar ligjërisht ta zbatojë.</i></p>
--	--

Bashkia, si njësi bazë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet Programit të Transparencës synon t’u garantojë qytetarëve të vet të drejtën e lirisë së shprehjes për çështjet vendore, duke vendosur në dispozicion të publikut një kategori të gjerë informacionesh, mënyrat dhe afatet e publikimit të tyre si dhe procedurat për t’i aksesuar e përdorur ato


# **PJESA I: PLANIFIKIMI DHE ZBATIMI I NJË FUSHATË TË SUKSESSHME NDËRGJEGJËSIMI**

Bashkitë për të Drejtën e Informimit Në Veprim

## Hapat për zbatimin e një e një fushate ndërgjegjësimi të suksesshme

- 1** Përcaktoni objektivat e fushatës suaj
- 2** Identifikoni audiencat target
- 3** Krijoni mesazhin tuaj
- 4** Përzgjidhni metodologjinë për të përçuar mesazhin
- 5** Realizimi i Fushatës
- 6** Vlerësimi i Fushatës





Përse është e nevojshme të planifikojmë fushatë të ndërgjegjësimit rreth të drejtës së informimit?  
 Përse çështja e të drejtës së informimit është e rëndësishme?  
 Përse komuniteti dhe grupe të caktuara duhet të ndërgjegjësohen?  
 Në fund të fundit, përse një fushatë nga bashkitë për të drejtën e informimit?


Këto pyetje lidhen ngushtësisht me qëllimin e këtij Udhëzuesi dhe kuptimi mbi këtë ndihmon në përcaktimin e qartë të nevojës për këtë fushatë.

Për të ndihmuar në përcaktimin e rëndësisë së fushatës, duhet filluar të identifikohet problemi, rëndësia e tij në komunitetin ku ju veproni/apo në të cilën do të realizoni fushatën e ndërgjegjësimit.

Një pikë fillestare për këtë përcaktim jepet si më poshtë:

- Nëse ligji për të drejtën e informimit duhet të jetë efektiv, qytetarët duhet të jenë të informuar dhe në dijeni të plotë për këtë të drejtë dhe se në ç'mënyrë ushtrohet kjo e drejtë.
- Zbatimi efektiv i ligjit pritet ndikojë në përmirësimin dhe rritjen e pjesëmarrjes dhe bashkëveprimin e publikut me qeverisjen lokale.
- Informimi i publikut dhe transparenca janë detyrim ligjore, ndaj është e nevojshëm që në fazat e hershme të zbatimit të ligjit, qeverisja lokale duhet të marrë një rol proaktiv në promovimin dhe ndërgjegjësimin publik rreth ligjit dhe mënyrën se si qytetarët të ushtrojnë këtë të drejtë.

## Hapi 1: Përcaktimi i objektivave



Gjatë planifikimit të një fushate ndërgjegjësimi filloni duke specifikuar qëllimin e përgjithshëm dhe objektivat e fushatës. Qëllimi i përgjithshëm i fushatës lidhet me pyetjen se përse po planifikoni një fushatë të tillë? Duhet të kihet parasysh që objektivat të jenë të qartë, të matshëm dhe të lidhen me veprimtaritë për audiencën e synuar.

### Përcaktimi i Objektivave

Përgjigjet e pyetjeve të mëposhtme do të ndihmojnë në përcaktimin e objektivave:

Cfarë doni të arrini me anë të fushatës?


- Të ndërgjegjësojmë publikun për të drejtën e informimit?
- Të ndërgjegjësojmë për ndonjë aspekt të veçantë të ligjit? P.sh. informimi me kërkesë programi i transparencës/koordinatori i transparencës/ fusha të veçanta të informacionit: paketën fiskale; procesin e vendimarrjes vendore; shërbimeve publike etj;
- Të edukojmë komunitetin rreth zbatimit të ligjit? Procedurave për t'u informuar e ankimuar?
- Të përmirësojmë angazhimin qytetar në proceset e vendim-marrjes në njësinë vendore?

Për përcaktimin e objektivave ndiqni modelin SMART:

S	Specifik: Objektivi të jetë i qartë.	Pyetje: Cfarë synohet të realizohet konkretisht? Kur? Ku? Si?	Informimi i qytetarëve rreth të drejtës së informimit në territorin e bashkisë X nëpërmjet përdorimit të një serie mjetesh të informimit publik përgjatë muajve Shtator – Dhjetor 2017
---	--------------------------------------	---	--

<b>M</b>	Të Matshëm: Ndajeni objektivin në elementë të matshëm që mund të vlerësohet ndikimi	Pyetje: Si do ta kuptoni që objektivi është realizuar?	Rreth 50% e popullatës është e informuar për të drejtën e informimit; Numri i kërkesave për informim nga qytetarët do të rritet me 20% në tremujorin e parë të 2019 krahasuar me mesataren e kërkesave të 2018; Programi i Transparencës i publikuar në ëbsitin e bashkisë do të klikohet X% më shumë së viti 2018
<b>A</b>	Të realizueshëm: Vlerësoni nëse objektivi është i realizueshëm duke pasur parasysh kufizimet në kohë, burime dhe angazhim.	Pyetje: Sa realist është objektivi duke pasur parasysh kufizimet?	
<b>R</b>	Relevant: Shpjegoni pse objektivi është i rëndësishëm për audiencën e synuar.	Pyetje: A ka interes audienca e synuar për arritjen e objektivit?	
<b>T</b>	Të kufizuara në kohë: Përcaktoni afatin kohor për realizimin e tyre.	Pyetje: Çfarë mund të realizohet tani? Po në gjashtë muaj? Po në një vit?	Fushata do të zgjasë për tre muaj (shtator – dhjetor 2018)

## Hapi 2: Identifikimi i audiencave të synuara



Audienca e synuar janë individët dhe grupet e ndryshme që ndikohen apo kanë interes për çështjen e fushatës së ndërgjegjësimit. Përcaktimi i qartë i audiencës së synuar është i rëndësishëm dhe kushtëzon çdo hap të fushatës. Kë doni të targetoni nëpërmjet fushatës?

A është kjo një fushatë që synon publikun e gjerë apo grupe të caktuara të shoqërisë/komunitetit?

- Qasja e përgjithshme – e drejta për informim duke targetuar gjithë popullatën e bashkisë;
- Qasja specifike – e drejta për informim dhe/ose proceset politikëberëse/vendimarrëse për grupet specifike të popullatës.

Përcaktimi i audiencës së synuar lehtësohet nëpërmjet pyetjeve:

- Kë përpiqemi të arrijmë, të edukojmë rreth të drejtës së informimit?
- Për kë kemi nevojë të përfshijmë për të siguruar një fushatë të suksesshme?
- Në ç'mënyrë grupet e ndryshme marrin informacion?
- Në ç'mënyrë këto grupe dëshirojnë të informohen?
- Për çfarë janë të interesuar?

Komunitetet përbëhen nga grupe të ndryshme:

<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Demografike: të rinjtë, të moshuarit, anëtarët e grupeve etnike;</li> <li>2. Gjeografike: lagje, qendra e qytetit/periferia, fshatrat e largët;</li> <li>3. Të tjerë: bizneset, OJQ-të, grupe të tjera (bluzat e bardha, mësuesit, fermerët);</li> <li>4. Etj.</li> </ol>	<p><i>Grupe të ndryshme por njësoj të rëndësishëm</i></p>
---	---

Bashkia duhet të kuptojë nevojat e ndryshme dhe prishmëritë e anëtarëve të grupeve të ndryshme të komunitetit!!!

Grupe të ndryshme kanë këndvështrime dhe interesa të ndryshme.

Dallimet ndërmjet tyre influencohen nga faktorë të ndryshëm, të tillë si: përvoja, gjinia, edukimi, standartet e jetesës ose mentaliteti i këtyre grupeve.

### Grupet Komunitare

Grupi	Cfarë bëjnë?	Cfarë kanë nevojë?	Si i mbështet bashkia?	Kush i përfaqëson?	Si informohen?
<b>FERMERET</b>	<p>Prodhojnë produkte bujqësore e blegtorale</p> <p>Sigurojnë të ardhura për familjet</p> <p>Kontribuojnë në organizimin e jetës në fshat</p>	<p>Informacione mbi marrjen e tokës me qera</p> <p>Procedurën e licensimit të fermerëve</p> <p>Shërbim veterinar dhe bujqësor</p> <p>Informacion rreth subvencioneve</p> <p>Informacion mbi shërbimin e vaditjes dhe kullimit</p> <p>Çertifikimin e tokës bujqësore</p> <p>Mbështetje për aplikime në skemat e subvencionimit</p> <p>Njohuri rreth politikave dhe instrumenteve të mbështetjes rurale</p>	<p>Taksa të reduktuara të tokës bujqësore</p> <p>Asistencë teknike bujqësore</p> <p>Informacion mbi subvencionet</p> <p>Përmirësimin e infrastrukturës lokale</p> <p>Sigurimin e tregjeve të shitjes</p> <p>Promovimin e produkteve lokale</p>	<p>Individualisht</p> <p>Shoqata fermerësh</p>	<p>Njësitë administrative dhe kryepletqë</p> <p>Drejtoria e Bujqësisë pranë Bashkisë</p> <p>Specialistët e bujqësisë në terren</p> <p>Website/ stenda e informimit/ telefonata</p> <p>Gazeta e Bujqësisë</p> <p>Fletëpalosje</p> <p>Biseda informale</p>


<b>Komuniteti rom &amp; egjiptian</b>	<p>Të angazhuar në disa sektorë të ekonomisë: tregëtimi i veshjeve të përdorura; pastrim; mbledhje kanaçesh; artizanat</p> <p>Komunitet lëvizës</p> <p>Fëmijë të përfshirë në lypje</p>	<p>Ndihmë ligjore;</p> <p>Shërbim shëndetësor</p> <p>Edukim/arsim</p> <p>Strehim</p> <p>Punësim</p> <p>Kurse profesionale</p> <p>Infrastrukturë publike (rrugë, ujësjellës, ndricim etj)</p> <p>Ndërgjegjësim</p> <p>Përfshirje sociale nga ana e popullatës maxhorancë</p> <p>Informacion në lidhje me aplikimin për skema të strehimit social, ndihmës ekonomike dhe mbështetjes financiare</p> <p>Informacion mbi mundësi punësimi</p>	<p>Shërbime sociale</p> <p>Qendra komunitare</p> <p>Skema të strehimit social</p> <p>Mundësira punësimi</p> <p>Kurse profesionale</p> <p>Lehtësim taksash</p> <p>Mbështetje në rast fatkeqësie/sëmundje</p> <p>Politika të përfshirjes sociale dhe integritit të komunitetit</p>	<p>OJF rome dhe egjiptiane</p> <p>Aktiviste të çështjes rome dhe egjiptiane</p> <p>Forume këshillimi</p>	<p>Punonjësit e administratës publike që punojnë në komunitet</p> <p>Administrator</p> <p>Punonjës Social</p> <p>Drejtuës shkollash</p> <p>Mësues</p> <p>Etj.</p>
---------------------------------------	---	---	--	--	---

Ndërveprimi – Qytetarë – Qeverisje lokale, stereotipet, nevojat dhe implikimet e ndërveprimit

Përse duhet të komunikojmë/ndërveprojmë së bashku?

	Qytetarët	Qeverisja lokale
Stereotipet për njëri-tjetrin	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Neglizhent</li> <li>● Nuk kanë aftësi komunikuese</li> <li>● Të painformuar/informohen për çështjet sipërfaqësisht</li> <li>● Të pa përfaqësuar, të paorganizuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Burokraci, të ngadalshëm</li> <li>● Paaftësi (në trajtimin e çështjes)</li> <li>● Punësime nepotike</li> <li>● Korrupsion</li> </ul>
Pse duhet të angazhohen me njëri-tjetrin?	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Të kërkojmë llogari për taksat që paguajmë</li> <li>● Të mbajmë qeverisjen të përgjeshme për besimin që I kemi dhënë</li> <li>● Interesat dhe nevojat e të gjitha grupeve të dëgjohen</li> <li>● Bashkëveprimi siguron transparencë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Për të siguruar legjitimitetin</li> <li>● Për të siguruar besimin</li> <li>● Për të zgjidhur problemet kryesore</li> <li>● Për të krijuar kohezion social</li> <li>● Për të rritur mbledhjen e taksave</li> <li>● Për të zbatuar ligjin</li> </ul>
Cilat janë implikimet për secilin nëse angazhohen në partneritet?	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Vendime efikase (duke përfshirë interesa të të dy palëve)</li> <li>● Rritje të cilësisë së shërbimeve</li> <li>● Rritja e cilësisë së jetës në komunitet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>● Kuptim më të mirë të problemeve të komunitetit</li> <li>● Menaxhim më të mirë të të ardhurave</li> <li>● Rritja e transparencës</li> <li>● Reduktimi i korrupsionit</li> <li>● Qëndrueshmëri në zhvillimin lokal</li> </ul>

## Hapi 3: Krijimi i mesazhit të fushatës së ndërgjegjësimit




Cfarë dëshironi të përçoni te audiencia e synuar? Në ç'mënyrë mund t'i përgjigjeni interesave dhe nevojave të tyre?

<p>Për të zhvilluar mesazhin e fushatës duhet të kihet parasysh:</p>	<p><b>Shembuj:</b> Drejtuar: Komunitetit Rom, ne jemi njëlloj</p>
<ul style="list-style-type: none"> <li>● Përshtatja e mesazhit me audiencën e synuar</li> <li>● Tregoni rëndësinë e të drejtës së informimit</li> <li>● Përshtatja e mjetit të komunikimit me audiencën e synuar</li> <li>● Ftojeni audiencën të marrë hapa veprimi specifik             <ul style="list-style-type: none"> <li>● Të bëjnë kërkesë për informacion</li> <li>● Të njihen me Programin e Transparencës së bashkisë</li> <li>● Të bëjnë një ankimim nëse u është refuzuar e drejta e informimit</li> <li>● Etj.</li> </ul> </li> <li>● Koha është gjithçka – Komunikim i hershëm dhe i shpeshtë.</li> <li>● Mesazhi duhet të jetë i shkurtër, tërheqës dhe inkurajues.</li> </ul>	<p><b>Strehim:</b> Ti je njësoj si unë</p> <p><b>Edukim:</b> Fëmijë drejt dijes! Edukimi ndryshon jetë!</p> <p><b>Përkrahje:</b> Demokracia nënkupton sheshim të dallimeve të çdo lloji</p> <p>Për publikun e gjerë</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>● Ne mundemi ta bëjmë ndryshimin</li> <li>● Ndryshimi nis nga ti</li> <li>● Like gjithëpërfshirjes, dislike paragjykitimit</li> </ul>



## Hapi 4: Përzgjedhja e aktiviteteve dhe strategjive



Shqyrtoni qëllimin dhe objektivat, audiencën që dëshironi të arrini dhe mesazhin kryesor që do të përcillni. Cilat aktivitete apo strategji do të përshtateshin me to? Cila do të ishte qasja e duhur për përmbushjen e objektivave të fushatës së ndërgjegjësimit?

Pasi të keni një listë të aktiviteteve, analizoni se cilat:

- Përshtaten më mirë me audiencën e zgjedhur
- Përshtaten me mesazhin e zgjedhur
- Mund të realizohen brenda buxhetit të caktuar
- Mund të zbatohen në mënyrë efektive duke marrë parasysh burimet në dispozicion.

### Listë aktiviteteve për ndërgjegjësimin publik për të drejtën e Informimit në nivel vendor #eDrejtaperInformimneVeprim #Bashkia


1. Sigurimi i mbështetjes për planifikimin dhe realizimin e fushatës nga kolegët në bashki
2. Përgatitja paraprake e bazës materiale për promovimin e ligjit
  - Fletëpalosje me informacione të ilustruara
  - Video-promovuese për median sociale
  - Prezantime power point për takimet e planifikuara
  - Postera të ilustruar pranë ambjenteve të bashkisë dhe instucioneve partnere
3. Shfrytëzimi i mundësive që ofrojnë mjetet tradicionale dhe jo-tradicionale të komunikimit
  - a. Dërgimi i NewsLetters të gjithë kontakteve (email) të qytetarëve të bashkisë
  - b. Njoftimi për shtyp në faqen zyrtare të bashkisë
  - c. Shkrim promovues në gazetën e bashkisë

4. Njoftimet e herëpashershme/periodike ne faqet zyrtare në rrjetet sociale shoqëruar nga tekst, video, foto, postera, grafike
5. Organizimi i sesioneve të informimit rreth të drejtës së informimit
6. Tour takimesh me qytetarë të komuniteteve të ndryshme gjeografike

**Listë aktivitesh për të fushatën e ndërgjegjësimit për edukimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë në sistemin parashkollor:**

1. Takimi me përfaqësuesit e OSHC-ve dhe aktivistë Romë dhe Egjiptianë të angazhuar në edukimin e fëmijëve rom/egjiptian;
2. Ftesë dhe angazhim i medias lokale për të prezantuar fushatën ndërgjegjëse)
3. Koha kur zhvillohet fushata: 8 prilli, Dita Nderkombëtare e Romëve;
4. Takime me komunitetin;
5. Poster informimi rreth të drejtave të fëmijëve;
6. Dokumentar (histori suksesi)
7. Fletë –palosje, të cilat mund të shpërndahen edhe nga Z1N;
8. Facebook
9. Mbyllja e takimit (aktivitet artistik me fëmijë të talentuar nga komuniteti Rom dhe Egjiptian)
10. Postim në Facebook (shoqëruar me foto ilustruese e kryetarit me fëmijët, sektori i shërbimit social me fëmijët, fëmijë në ambientet e cerdhes dhe kopshtet, foto të prindërve të lumtur që fëmijët e tyre janë në cerdhe dhe kopësht etj ), një video e shkurtër me mesazhe nga prinderit e femijeve te kom.të cilet ndjekin tashmë arsimin parashkollor
11. Instagram: #tibejmefemijetteqeshin #bashkeperedukiminebrezave (foto ilustruese)
12. Media vizive - Kronika (të hulumtohet mbi Tv lokal i cili të jetë më i preferuar/më i ndjekur)
13. Video montazh (që përfshin pamje nga takimi konsultues në bashki dhe te takimit me komunitetin
14. Intervistë me kryetarin e bashkisë, dhe/ose drejtoreshën e shërbimeve sociale ose drejtoreshën e cerdhes/kopshtit duke theksuar rëndësinë dhe përkushtimin e stafeve ndaj fëmijevëve.

## Hapi 5: Përzgjedhja e kanaleve të komunikimit




Ky hap lidhet me përzgjedhjen e metodës më të përshtatshme për të përçuar mesazhin të grupi i synuar. Përzgjedhja e metodës më të përshtatshme bëhet ndërmjet – nga njëra anë të kuptuarit e mënyrave se si audiencia e targetuar informohet dhe, nga ana tjetër, metodave dhe mjeteve që kemi në dispozicion.


Cilat janë metodat dhe mjetet në dispozicion për të komunikuar me audiencia të ndryshme?

- Broshurë/fletëpalosje/poster
- Stenda informimi publik
- Gazetë, radio, Tv
- Ftesa/posta
- Mbledhje publike
- Takime informuese
- Faqja zyrtare e internetit të bashkisë

Ka një shumëllojshmëri mjetesh komunikimi që mund të ndihmojnë në përcjelljen e mesazheve tuaja. Mjetet e informimit ndahen në tradicionale dhe jotradicionale:




## Hapi 6: Zbatimi i planit të fushatës



Në këtë fazë është e rëndësishme ndarja e përgjegjësi: kush do të bëjë, çfarë dhe kur. Aktivitetet e fushatës së ndërgjegjësimit të përkthehen në detyra më të vogla dhe detajimi i tyre, afatet dhe personat përgjegjës. Në përputhje me planin e hartuar realizohet edhe fushata.

1. Sa shpesh do të ktheheni të audiencës së synuar/komuniteti?
2. Kush është përgjegjës për aspekte të ndryshme të fushatës?
3. Vendosni afate kohore të qarta dhe rezultate të synuar
4. Në veprim: realizoni fushatën!!!

## Hapi 7: Monitorimi dhe vlerësimi i fushatës së ndërgjegjësimit




Deri në ç'masë fushata e ndërgjegjësimit arriti objektivat e synuara? Dy procese – monitorimi dhe vlerësimi ndihmojnë në vlerësimin e shkallës së ndikimit të fushatës që kemi ndërmarrë.

- **Monitorimi** është ndjekja në mënyrë të vazhdueshme të aktiviteteve dhe produkteve të parashikuara. Ka të bëjë me gjurmimin e arritjes së audiencës së synuar (sa është numri i audiencës që është ka marrë pjesë në aktivitete/sipas gjinisë/grupmoshës/vendndodhjes etj); numri dhe lloji i ndërveprimit në mediat sociale. etj
- **Vlerësimi** lidhet me ndryshimet që ka sjellë nisma apo fushata e ndërmarrë në çështjen e saj. A ka ndikuar në ndryshimin e sjelljes së audiencës së synuar ekspozimi i tyre ndaj aktiviteteve të fushatës apo nismës së ndërmarrë? Lidhet me të pyeturit e anëtarëve të audiencës dhe vlerësimin e shkallës së ndërgjegjësimit dhe njohurive rreth çështjes.

Treguesit e performancës:

- # i personave të informuar rreth të drejtës së informimit
- # i fletëpalosjeve/posterave/ videove/postimeve në mediat sociale/i sms/takimeve etj.
- # i angazhimeve në mediat sociale (post engagements)
- # i kërkesave për informim; tregues krahasimorë me vitet e mëparshme
- # i vizitorëve në faqen zyrtare të internetit të bashkisë; faqet më të vizituara
- # i ankimeve që qytetarët bëjnë në rast të mohimit të drejtës për informim
- % e qytetarëve që shprehen se janë të informuar rreth të drejtës së informimit
- Etj.

Për këtë, zhvillimi i një modeli logjik mund të jetë një mënyrë e dobishme për vlerësimin e ndikimit.



# **PJESA II: PRAKTIKA TË MIRA NË NDËRGJEGJËSIMIN PUBLIK PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

### Praktika të mira në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar

Gjatë viteve të fundit, krahas formave tradicionale të informimit dhe konsultimit publik, shumë prej njësive të qeverisjes vendore kanë filluar të bëjnë pjesë të faqeve të tyre të internetit forma të reja të informimit dhe konsultimit publik në mënyrë që të rritet transparenca dhe llogaridhënia.

Përvoja e vendeve të rajonit dhe më gjerë ka treguar se përdorimi i mjeteve të teknologjisë së informacionit (ICTs) çon në përmirësimin e aksesit në informacion dhe përfshirjen në vendimmarrjen vendore, si edhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike. Format e reja elektronike mund të zvogëlojnë barrën administrative për publikun dhe uljen e kostove të transaksionit gjatë ndërveprimit me njësitë vendore. Më poshtë janë përshkruar disa praktika të mira vendore dhe ndërkombëtare lidhur mënyrat dhe mjetet e reja të informimit dhe përfshirjes së qytetarëve të ndërmarra nga njësitë e qeverisjes vendore.

#### Në nivel vendor

<p><b>Bashkia Shkodër</b></p>	<p>“Transparenca e buxhetit” është një platformë elektronike ku pasqyrohen të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkisë Shkodër duke filluar nga viti 2016. Kjo platformë ka të integruar edhe përlllogaritësin “Taksat e mia”. “Taksat e mia” është një hapësirë virtuale ku qytetarët e Bashkisë Shkodër mund të informohen për taksat dhe tarifatat vendore. Ky mekanizëm gjendet i vendosur në faqen kryesore të internetit të bashkisë.</p> <p>“Transparenca e buxhetit” <a href="http://scm.smartprocesses.net/smartapps/scm/geoportal/map.aspx">http://scm.smartprocesses.net/smartapps/scm/geoportal/map.aspx</a></p> <p>“Taksat e mia”</p> <p><a href="http://scm.smartprocesses.net/smartapps/scm/geoportal/TaksatEMia.aspx">http://scm.smartprocesses.net/smartapps/scm/geoportal/TaksatEMia.aspx</a></p>
-------------------------------	---

<p><b>Bashkia Tiranë</b></p> <p><b>Aplikacioni:</b> Tirana ime - është një udhëzues dixhital për kryeqytetin, me qëllimin e vetëm për lehtësuar dhe përmirësuar jetën e qytetarëve të Bashkisë Tiranë. Ky aplikacion përfshin 6 kategori të ndryshme (Trafiku, Transporti, Ndotja, Informacion, Raportime, Turizmi), me informacion të nevojshëm në kohë reale. Gjithashtu qytetarët mund ta përdorin për të raportuar shqetësimet e tyre lidhur me këto fusha.</p>
---



**Portali “Open Data Tirana”** (<http://opendata.tirana.al/>) është një platformë elektronike me të dhëna statistikore të bashkisë në format dhe licensë të hapur (open data) dhe lehtësisht të analizueshme (machine readable).

Gjithashtu duke përdorur portalin e-Albania Bashkia Tirane ofron mundësinë për bizneset dhe pronarët që operojnë në Bashkinë e Tiranës që të informohen për taksat dhe tarifat e papaguara vendore, si dhe t'i paguajnë ato online. [https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=12498](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=12498)

### **Bashkia Lezhë**

Drini është një gazetë periodike e përmuajshme, botim i Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Zhvillimit Rural në bashki për të informuar kryesisht për sektorin e zhvillimit rural. ([http://www.lezha.gov.al/ëeb/Publikime\\_603\\_1.php#.WDMfs4za72](http://www.lezha.gov.al/ëeb/Publikime_603_1.php#.WDMfs4za72))

### **Bashkia Elbasan**

Almanak është një gazetë falas në formë elektronike dhe e printuar që shërben për të informuar qytetarët në tërësi lidhur me veprimtarinë e bashkisë Elbasan. (<http://elbasani.gov.al/sq-al/Galeria/Pages/Botime.aspx>)

### **Bashkia Korçë**

Aplikacioni “Përmirëso Qytetin!” (<http://www.permiresoqytetin.al/index1.php>)

‘Përmirëso Qytetin’ është një platformë elektronike pjesë e faqes së internetit të bashkisë Korçë nga ku qytetarët të mund të dërgojnë ankesat e tyre dhe të marrin përgjigje sa më shpejt për problemin. Gjithashtu, platforma ‘Përmirëso Qytetin’ krijon mundësinë e një rrejt social ku qytetarët mund të diskutojnë dhe të japin vlerësime për çështje të ndryshme që të afrojnë sa më shumë qytetarin në vendimmarrjet e bashkisë, në zgjidhjen e problemeve të shumta.

## Në nivel rajonal dhe ndërkombëtarë

### **Portali qeveritar (e-governance)**

Në Serbi portali qeveritar (e-governance) dhe i konsultimit publik elektronik mundëson që të gjitha nivelet e qeverisjes të ofrojnë shërbime publike në mënyrë elektronike si dhe mundëson konsultimin publik elektronik.

### **Sistemi 48 orë**

Sistemi i 48-orëve, që zbatohet në shumë prej bashkive në Serbi dhe rajon, është një aplikacion ku qytetarët mund të raportojnë problematika dhe gjatë 48 orëve qytetarët marrin një përgjigje nga bashkia për çështjen e ngritur.

**Tregoje në hartë** (Tell it on the Map: kerrokaartalla.hel.fi | www.hel.fi | <https://www.kuntalaisaloite.fi>)

Bashkia në Helsinki, Finlandë kanë udhëzime shumë të qarta në faqen zyrtare të internetit lidhur me format e përfshirjes në vendimmarrje jo vetëm në mënyrë virtuale/elektronike. Një nga mjetet e bashkisë është Tregoje në hartë/Tell it on the Map“ (kerrokaartalla.hel.fi) ku qytetarët mund të dërgojnë propozimet dhe sugjerimet e tyre mbi politikën vendore dhe deri tek problematikën e përditshmërisë së qytetit.

Një model tjetër për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje është platforma elektronike <https://www.kuntalaisaloite.fi> ku qytetarët mund të propozojnë politikën si në nivel kombëtar ashtu edhe vendor.

## **Vlerësime të Koordinatorëve për të Drejtën e Informimit:**

### **Elsa Hajdëri, Koordinatorë për të Drejtën e Informimit, Bashkia Kuçovë**

*“Ky trajnim shërbeu si një mundësi e mirë për të krijuar ura komunikimi me kolegë në bashki të tjera të Shqipërisë, Gjithashtu, patëm mundësi për të shkëmbyer eksperiencën në fushën e zbatimit të ligjit “Për të Drejtën e Informimit”, të cilat më shërbyen për një vizion më të qartë rreth asaj që më duhet të bëj në punën time.*

*Një ndër gjërat që vlerësova më shumë ishte puna në grupe, nga të cilat do të veçoja realizimin e një fushate ndërgjegjëse për opinionin publik. Kjo më shërbeu të përcaktoj qartë atë çfarë grupi shoqëror të cilit po i drejtohem kërkon dhe intereson të dijë. Me njohuritë dhe aftësitë që përfitova në trajnim, më datë 28 Shtator do të realizoj një takim me të rinjtë e Qendrës Rinore, me qëllim ndërgjegjësimin e tyre për të drejtën e informimit.”*

### **Ana Thana, Koordinatorë për të Drejtën e Informimit, Bashkia Vorë**

*“E them me bindje të plotë që kam marrë pjesë në shumë trajnime gjatë këtyre viteve që punoj në bashkinë Vorë, por ama ky ishte një ndër trajnimet më të mira, më produktive. Organizimi dhe në vecanti mënyra e shpjegimit më pëlqyen shumë. Gjithmonë kam besuar që puna në grup ndihmon dhe fakti që në këtë trajnim patëm punë në grup më pëlqeu. Ndarja e eksperiencave të ndryshme me kolegët e bashkive të tjera na ndihmon shumë në punën tonë të përditëshme.”*

### **Ervin Doda Koordinatorë për të Drejtën e Informimit, Bashkia Kamëz**

*“Trajnimi na aftësoi në lidhje me strategjitë që duhet të ndjekin bashkitë për ndërgjegjësimin e grupeve të ndryshme komunitare në lidhje me të drejtën e informimit.*

*Gjithashtu, sesioni mbi pjesëmarrjen qytetare në qeverisjen vendore edhe njëherë përforcoi nevojën e informimit të titullarëve të institucionit për të përdorur ligjin për të drejtën e informimit si një mënyrë për të rritur besimin e qytetarëve në qeverisjen vendore, dhe sigurimin e legjitimitetit.”*